

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIII, nr. 6953  
E mërkurë, 26 korrik 2023  
Çmimi 0.40 €

## Republika e Çekisë emëron ambasador në Kosovë për herë të parë

FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## QYTETARËT TË KËNAQUR ME KURTIN E OSMANIN, TË PAKËNAQUR ME DREJTIMIN EKONOMIK E POLITIK QË PO MERR VENDI



Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) ka publikuar të dhënat e Pulsit Publik bazuar në intervistat e realizuara gjatë muajit prill 2023. Në leximin e të dhënave të këtij Pulsi Publik vërehet një shpërputhje e madhe në mes të pëlqyeshmerisë që të anketuarit

kanë treguar për punën e institucioneve të Kosovës, kryeministrit Albin Kurti e presidentes Vjosa Osmani dhe në mes të opinionit të tyre për drejtimin politik dhe ekonomik të vendit. Sipas Pulsit Publik të UNDP-së, 45.6 % e qytetarëve të Kosovës nuk janë aspak të

kënaqur me drejtimin politik të vendit. Derisa 31.2 % kanë preferuar të mbesin neutralë, vetëm 23.2 % janë shprehur të kënaqur në përgjigjet e tyre. Papunësia, varfëria dhe inflacioni u renditën tre problemet e natyrës më urgjente në Kosovë

### AKTUALE



MIJËRA MERCENARË TË WAGNERIT  
KANË MBËRRITUR NË BJELLORUSI  
QË NGA REBELIMI I DËSHTUAR F. 2

ABDIXHIKU PRET NË TAKIM  
SZUNYOGIN, SHPALOS PLANIN  
SHTATËPIKËSH PËR VERIUN F. 7

MBI 45 MILIONË EURO BORXHE  
NDAJ KRU 'PRISHTINA' F. 8

### EKONOMI



BIE NUMRI I FAMILJEVE  
PËRFITUESE NGA SKEMA  
SOCIALE F. 8

MUNGESA E FUQISË PUNËTORE  
NË KOSOVË, RAFUNA:  
PO SHQYRTOHET OPSIONI  
PËR PUNËTORË NGA TRI  
VENDE TË HUAJA F. 8

### SPORT



KRASNIQI PARA DUELIT ME  
MOHAMEDIN: FRIKËN S'E MENDOJ  
KURRË, DO TË SHIHNI DIÇKA JASHTË  
NORMALES F. 10



**NDRYSHIMET  
QË DIASPORA  
DO TË DONTE  
T'I SHIHTE NË  
KOSOVË** | FAQE 7

**'FESTO  
ME ZEMËR,  
JO ME ARMË',  
MPB-ja I PRET  
MËRGIMTARËT  
NË MERDAR** | FAQE 8



**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegjibiznesi.com](http://www.kolegjibiznesi.com)  
info@kolegjibiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBANJIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVE  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...



# Mijëra mercenarë të Wagnerit kanë mbërritur në Bjellorusi që nga rebelimi i dështuar

MINSK, 25 KORRIK - Mijëra mercenarë të grupit të lidhur me Rusinë, Wagner, kanë mbërritur në Bjellorusi që nga rebelimi jetëshkurtër i këtij grupi, ka thënë të hënën një grup vëzhgues ushtarak.

Besohet se 3 450 deri në 3 650 ushtarë kanë shkuar në një kamp afër Asipoviçi, një qytet 230 kilometra në veri të kufirit ukrainas, sipas Belaruskij Hajun, grupit i cili i gjurmon lëvizjet e trupave ushtarake brenda vendit.

Presidenti i Bjellorusisë, Alexander Lukashenko, i mirëpriti forcat e Wagnerit në vendin e tij, pasi e kishte ndërmjetësuar një marrëveshje mes Kremlinit dhe shefit mercenar Yevgeny Prigozhin muajin e kaluar, duke i dhënë fund rebelimit të dështuar të grupit kundër liderëve të ushtrisë ruse.

Shefi i Wagnerit e quajti rebelimin "marshi i drejtësisë" për t'i rrëzuar liderët kryesorë

ushtarakë. Mercenarët u përballën me qëndresë të vogël dhe i rrëzuan të paktën gjashtë helikopterë ushtarakë dhe një aeroplan luftarak, duke i vrarë një numër ushtarësh rusë.

Kjo kryengritje ishte kërcënimi më serioz ndaj presidentit rus Vladimir Putin gjatë sundimit të tij 23-vjeçar, duke ia dobësuar autoritetin dhe duke ia nxjerr në pah dobësitë e qeverisë.

Imazhet satelitore tregojnë se rreth 700 automjete dhe pajisje ndërtimi kanë mbërritur në autokolona të Wagnerit në Bjellorusi, tha Belaruskij Hajun.

Prigozhini e ka regjistruar një "kompani për menaxhimin e patundshmërisë" në Bjellorusi javën e kaluar me emër Concord Management and Consulting in Belarus. Dokumentet e analizuar nga mediumi i pavarur bjellorus reform.by tregojnë se



kompania është regjistruar në adresën e njëjtë të fshatit ku është i vendosur kampi mercenar Wagner.

Ndërkohë, zyrtarët vendorë thanë të hënën se mercenarët po vazhdojnë të punojnë me trupat bjelloruse, përfshirë qendrat stërvitore afër kufirit polak.

"Luftëtarët e Wagnerit, të cilët kanë qenë në zjarrin e luftës,

po u japin informacione dhe përvojë të vlefshme ushtarëve tanë", tha Ministria e Mbrojtjes e Bjellorusisë në një komunikatë.

Pas një takimi me presidentin rus të dielën, Lukashenko tha se trupat e Wagnerit po e "stresonin atë" duke i kërkuar ta bëjnë një "ekskursion" në Poloni.

Këto deklarata janë hedhur

poshtë nga ekspertët, me Institutin Amerikan për Studimin e Luftës që tha se trupat e Wagnerit nuk mund ta kërcënojnë Ukrainën dhe Poloninë. "Nuk ka indikacione se luftëtarët e Wagnerit në Bjellorusi kanë armatim të rëndë, që është i nevojshëm për të ndërmarrë ofensivë serioze kundër Ukrainës apo Polonisë, pa riarmatim serioz", tha Instituti amerikan të dielën.

Nënkryetari i Drejtorisë Kryesore të Inteligjencës së Ukrainës, Vadym Skibitsky, tha se nuk ka "kërcënim direkt" nga mercenarët rusë në Bjellorusi, por se Kievi do t'i mbajë nën vëzhgim luftëtarët e Wagnerit.

"Vlerësimi ynë është shumë i thjeshtë: Sot nuk ka kërcënim direkt (nga Bjellorusia), por ne jemi gati. Ne po vëzhgojmë çdo gjë që lidhet me të ashtuquajturin sistem i mbrojtjes raketore Wagner", tha ai.

## Greqia vazhdon luftën me zjarret



ATHINË, 25 KORRIK - Greqia vazhdon përpjekjet për t'i kontrolluar zjarret në ishullin Rodos për të shtatën ditë me radhë.

Qindra turistë që u detyruan të evakuhohen pritet të kthehen në vendet e tyre.

Rreth 20 000 njerëz u larguan nga shtëpitë dhe hotelet në Rodos, ditët e fundit, pasi zjarret që nisën një javë më parë, u përhapën dhe arritën vendpushimet bregdetare në juglindje të ishullit.

Greqia përfshihet shpesh nga zjarret, sidomos gjatë verës, por ndryshimet klimatike kanë shkaktuar sivjet valë më ekstreme të të nxehtësi në të gjithë Evropën jugore.

Qindra zjarrfikës, me përforsime nga Turqia dhe Sllovakia, janë duke luftuar me

flakët pranë fshatrave Genadi dhe Vati në juglindje të Rodosit. Zjarret shpërthyen edhe në ishullin e Korfuzit, në pjesën perëndimore të Greqisë, dhe në ishullin Evia, pranë kryeqytetit të Athinës. "Zjarret kanë përfshirë gjithë vendin, por asnjë vendbanim nuk po kërcënohet për momentin", tha një zyrtar i brigadës së zjarrfikësve për agjencinë e lajmeve Reuters.

Greqia ka shënuar temperatura shumë të larta javët e fundit dhe ato pritet të mbeten të tilla së paku deri të mërkurës, duke i tejkaluar 44 gradë celsius në disa zona. Turizmi përbën 18 % të prodhimit të Greqisë dhe një në pesë vende pune. Në Rodos dhe shumë ishuj të tjerë grekë, varësia nga turizmi është edhe më e madhe.

## Tërmet 5.5 shkallësh në Adana të Turqisë

ANKARA, 25 KORRIK - Një tërmet 5.5 shkallësh i Rihterit e ka goditur provincën jugore të Turqisë, Adana, në mëngjesin e së martës, sipas Qendrës për Monitorim të Tërmeteve Kandilli.

Qendra ka thënë se tërmeti është regjistruar në orën 8:44 të mëngjesit.

Epiqendra e tërmetit ka qenë në Kozan, rreth 64 kilometra

nga qyteti i Adanas.

Autoritetet nuk kanë raportuar për të lënduar apo shtëpi të dëmtuara.

Tërmeti ndodhi disa muaj pas tërmeteve shkatërruese të shkurtit në këtë shtet dhe në disa pjesë në veri të Sirisë.

Vetëm në Turqi kanë vdekur më shumë se 50 000 persona dhe dhjetëra mijëra ndërtesa janë shkatërruar.

Shumë prej shtëpive të dëmtuara, si pasojë e tërmeteve të shkurtit, nuk janë shembur ende nga autoritetet.

Orhan Tatar, udhëheqës i Departamentit për Shkurtim të Rrezikut në Autoritetin për Menaxhim të Katastrofave, i ka bërë thirrje publikut të qëndrojë larg ndërtesave të dëmtuara.





## Dy seanca parlamentare këtë javë

PRISHTINË, 25 KORRIK - Shefja e deputetëve e Lëvizjes Vetëvendosje, Mimoza Kusari-Lila, ka thënë se të enjten dhe të premten do të ketë seancë të Kuvendit. Seanca e së

premtës, sipas Kusari-Lilës, do të jetë e fundit për sesionin pranveror. “Një seancë mbahet të enjten me pika të papërfunduara dhe të premten do të ketë seancë të re e që do të jetë

seanca e fundit për këtë sesion pranveror. Të premten do të jetë në rend dite edhe Projektligji për Pensionet, të cilin qeveria ka rekomanduar Kuvendit”, ka thënë ajo.

Mbledhja e Kryesisë ka dështuar për shkak të kuorumit. Thirrja e seancës tani do të bëhet me ftesë të kryeparlamentarit Glauk Konjufca.



## “Festo me zemër, jo me armë”, MPB-ja i pret mërgimtarët në Merdar

PRISHTINË, 25 KORRIK - Duke iu dëshiruar mirëseardhje në vendlindje mërgimtarëve që vinin në Kosovë përmes pikës së kalimit kufitar në Merdar, zëvendësministri i Punëve të Brendshme, Blerim Gashani, ka diskutuar me ta për fushatën që është duke e organizuar Ministria e Punëve të Brendshme kundër të shtënave festive: “Festo me zemër, jo me armë”.

Sipas një njoftimi për medie, bëhet me dije se me këtë rast Gashani ka kërkuar nga mërgimtarët që bashkë me institucionet t'i shpërndajë mesazhet kryesore të kësaj fushate, për të gjithë familjarët e tyre për rreziqet dhe pasojat që vijnë nga të shtënat festive. “Mërgimtarët janë një aset i madh për shtetin e Kosovës dhe për gjallërinë që sjellin në vendlindje. Ju kemi përzgjedhur ju, me qëllim që të na ndihmoni të shpërndani këtë mesazh për rrezikun që kanë të shtënat festive dhe t'i raportoni rastet te Policia e Kosovës. Vetëm duke punuar së bashku mund të ndihmojmë në parandalimin e kësaj dukurie negative e cila i përket së kaluarës”, ka theksuar Gashani. Më tutje në njoftim, koordinatori për armë të vogla dhe të lehta, Gashani, gjatë bashkëbisedimit me mërgimtarë, vuri në dukje rreziqet që vijnë nga të shtënat



me armë, por edhe pasojat juridike që do t'i kenë qytetarët që shtënë me armë, prandaj theksoi ai është e rëndësishme të festohet pa armë. Ndërsa mërgimtarët e mirëpritën nismën e Ministrisë së Punëve të Brendshme për parandalimin

e të shtënave festive dhe theksuan gatishmërinë e tyre që të njëjtat mesazhe që morën sot, do t'i ndajnë edhe me familjarët dhe të afërmit e tyre. Ministria e Punëve të Brendshme më 30 qershor filloi zyrtarisht fushatën

“Festo me zemër, jo me armë” me aktivitete në shkolla, takime me Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, institucionet e sigurisë, institucionet fetare dhe assemble komunale në qytete të ndryshme në Kosovë. Aktivitete të tjera do ta

përcjellin fushatën gjatë ditëve dhe muajve në vijim, për ta ngritur ndërgjegjësimin e qytetarëve për ta rritur numrin e raportimeve për të shtënat festive. Kjo fushatë është duke u mbështetur nga UNDP dhe SEESAC.



## Tahiri: Në shtator duhet ta kemi në rend dite mocionin e mosbesimit ndaj qeverisë Kurti

PRISHTINË, 25 KORRIK - Shefi i grupit parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Besnik Tahiri, ka kërkuar që mocioni i tyre për mosbesim ndaj qeverisë Kurti të përkrahet nga opozita. “Kjo qeveri këtë vit po

karakterizohet si qeverisja më e dobët. Si grup parlamentar ne nuk do të bëjmë asnjë kuorum dhe nuk do të votojmë asnjë projektligj”, ka thënë ai. Tahiri ka theksuar se qeveria Kurti nuk e meriton asnjë mbështetje. “Ne si opozitë

duhet ta shtyjmë mocionin përpara dhe ka një dakordim për këtë çështje dhe në shtator duhet ta kemi në rend dite mocionin e mosbesimit”, ka thënë Tahiri për gazetarë në ambientet e Kuvendit të Kosovës.

## Projekti i banesave për familjet e dëshmorëve në Skenderaj drejt përfundimit

Skenderaj, 25 korrik - Kryetari i komunës së Skenderajt, Fadil Nura, ka njoftuar se projekti i objekteve banesore dedikuar familjeve të dëshmorëve është

drejt përfundimit. Nura është shprehur i lumtur që po fillon të përmbushet edhe një premtim tjetër, më i rëndësishmi që prej nisjes së

mandatit të tij. “Projekti i objekteve banesore dedikuar familjeve të dëshmorëve, që po zhvillohet me ritëm të përshpejtuar të punës, për ta

bërë gati për banim brenda këtij viti dhe për t'i vënë kapakun një zotimi tjetër për kategoritë e luftës”, ka shkruar Nura në “Facebook”.







# Qytetarët të kënaqur me Kurtin e Osmanin, të pakënaqur me drejtimin ekonomik e politik që po merr vendi

Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) ka publikuar të dhënat e Pulsit Publik bazuar në intervistat e realizuara gjatë muajit prill 2023. Në leximin e të dhënave të këtij Pulsi Publik vërehet një shpërputhje e madhe në mes të pëlqyeshmerisë që të anketuarit kanë treguar për punën e institucioneve të Kosovës, kryeministrit Albin Kurti e presidentes Vjosa Osmani dhe në mes të opinionit të tyre për drejtimin politik dhe ekonomik të vendit. Sipas Pulsit Publik të UNDP-së, 45.6 % e qytetarëve të Kosovës nuk janë aspak të kënaqur me drejtimin politik të vendit. Derisa 31.2 kanë preferuar të mbesin neutralë, vetëm 23.2 % janë shprehur të kënaqur në përgjigjet e tyre. Papunësia, varfëria dhe inflacioni u renditën tre problemet e natyrës më urgjente në Kosovë

**EPOKA  
ERE**

**Faton DËRMAKU**

**PRISHTINË, 25 KORRIK** - Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në Kosovë ka publikuar sot edicionin e 24-t të Përmbledhjes Pulsit Publik. Anketa e opinionit të Pulsit Publik, bazuar në intervistat e kryera në prill 2023, paraqet gjetjet mbi dhjetë treguesit kryesorë që mbulojnë çështjet socio-ekonomike, mjedisore dhe politike, duke përfshirë drejtësinë tranzicionale. Si me të gjitha publikimet e mëparshme, të dhënat dhe treguesit janë të ndarë sipas përkatësisë etnike dhe gjinisë për të ofruar informacion të

hollësishëm mbi dallimet në perceptimet e sfidave të zhvillimit me të cilat përballen njerëzit që jetojnë në Kosovë. Disa nga gjetjet kryesore nga anketa e muajit prill 2023 përfshijnë: Rritje të kënaqshmërisë e të anketuarve me punën e të gjitha institucioneve qendrore të Kosovës. Mesatarisht 45.8 % të të anketuarve ishin të kënaqur me punën e tyre. Kënaqshmëria me performancën e kabinetit ekzekutiv është regjistruar në 45.8 %, duke shënuar një rritje prej 4.8 pikë përqindjeje krahasuar me nëntorin e 2022-s. Kënaqshmëria me punën e kryeministrit kapi vlerën prej

51.5 %, ngritje kjo për 6.6 pikë përqindje krahasuar me nëntorin e 2022-s. Kënaqshmëria me punën e Kuvendit kapi vlerën prej 46.5 %, krahasuar me 39.1 % në nëntor 2022, ndërsa kënaqshmëria me kryetarin e Kuvendit të Kosovës ishte 58.3 %, krahasuar me 50.8 % në nëntor 2022. Niveli i kënaqshmërisë me presidenten kapi vlerën 60.3 % krahasuar me 56.8 % në nëntor 2022. Ka pasur rritje në shkallën e kënaqshmërisë me gjykatat dhe Zyrën e Kryeprokurorit, duke kapur vlerën prej 29 % për të dyja institucionet, krahasuar me 24.4 % dhe 22 % përkatësisht, në nëntor 2022. —>

## Krasniqi: Vendit i duhet një qeveri e përgjegjshme dhe kredibile

Kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, ka komentuar publikimin më të ri të Pulsit Publik, realizuar nga UNDP-ja dhe financuar nga USAID-i. Krasniqi ka thënë se me këtë puls publik u dëshmuua ajo të cilën e kanë thënë vazhdimisht dhe zëshëm kohën e fundit. "Qytetarët e Kosovës nuk janë të kënaqur me drejtimin politik të vendit dhe se kjo qeveri, përjashtuese me aleatë ndërkombëtarë dhe koordinuese me kriminelë, nuk është duke përfaqësuar vullnetin e tyre. Sipas Pulsit Publik të UNDP-së, 45.6 % e qytetarëve të Kosovës nuk janë aspak të kënaqur me drejtimin politik të vendit. Ndërkaq, derisa 31.2 kanë preferuar të mbesin neutralë, vetëm 23.2 % janë shprehur të kënaqur në përgjigjet e tyre. Edhe një herë kjo dëshmon për urgjencën e ndërrimit të drejtimit politik që ka marrë vendi, i cili nuk mund të bëhet pa ndërrimin e qeverisë", ka shkruar Krasniqi në "Facebook".

Ai ka theksuar se rruga e rrezikshme në të cilën kjo qeveri e ka futur vendin nuk është problemi i vetëm për qytetarët tanë. "Papunësia, varfëria, inflacioni, çmimet e larta të produkteve esenciale dhe shërbimet jodinjitoze shëndetësore janë renditur si pesë problemet më të mëdha sociale. 78 % e qytetarëve mendojnë se punësimi në institucionet publike nuk bëhet në baza meritore. Kjo pakënaqësi qytetare, e dëshmuar edhe në pasoja reale për shtetin tonë, përmes masave dhe sanksioneve nga aleatët tanë, duhet të adresohet urgjentisht", ka thënë ai. Ai ka thënë se kjo mund të bëhet vetëm përmes zgjedhjeve të parakohshme, të cilat do t'i sillnin vendit një qeveri të përgjegjshme dhe kredibile, e cila, përmes veprimeve të saj, do ta rikthente Kosovën në drejtimin e duhur politik - drejt integritimit të paalternativë euroatlantik.



# Republika e Çekisë emëron ambasador në Kosovë për herë të parë

PRISHTINË, 25 KORRIK - Republika e Çekisë do ta dërgojë ambasadorin e vet në Prishtinë për herë të parë, 15 vjet pasi e njohu pavarësinë e Kosovës, njoftoi Ministria e Punëve të Jashtme e Çekisë të martën.

Presidenti i Republikës së Çekisë, Petr Pavel, e ka emëruar Bohumil Mazanekun ambasador në Kosovë, me propozimin e qeverisë.

Ministria e Punëve të Jashtme e Çekisë sqaroi për Radio Evropa e Lirë se deri më tani në krye të misionit diplomatik ka qenë "i ngarkuari me punë", kurse tani është emëruar ambasadori.

Qeveria e ish-kryeministrit Mirko Topolaneq njohu pavarësinë e Kosovës në vitin e shpalljes së saj më 2008.

Derisa qëndrimi i shtetit çek rreth pavarësisë nuk ka ndryshuar kurrë, dy presidentët e kaluar të Çekisë, Vaclav Klaus dhe Milosh Zeman, nuk kishin emëruar ambasador çek në Kosovë, madje ky i fundit kishte propozuar edhe tërheqjen e njohjes.

Petr Pavel, ish-shef i ushtrisë çeke dhe zyrtar i lartë i NATO-s, nisi mandatin pesëvjeçar në postin e



presidentit të Republikës Çeke më 9 mars.

Ambasadori i emëruar,

Mazanek, është një prej diplomatëve çekë me diplomë nga Instituti Shtetëror për

Marrëdhënie Ndërkombëtare i Moskës, dhe deri tani ka qenë ambasador në Lituani, i ngarkuar

me punë në Tajlandë dhe konsull i përgjithshëm në Kinë dhe Poloni.



## KQZ-ja vendos për asgjësimin e materialit të zgjedhjeve të 23 prillit në veri

PRISHTINË, 25 KORRIK - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me tetë vota për ka marrë vendim ta asgjësojë materialin zgjedhor për zgjedhjet e 23 prillit për kryetar të komunave: Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok. Gjithashtu, edhe për materialin e zgjedhjeve të parakohshme për kuvendet e komunave: Zveçan dhe

Leposaviq, raporton Komisioni Qendror i Ekonomia Online. Në mbledhje është edhe raporti për realizimin e planit të punës të KQZ-së si dhe shtojca "Raport i realizimit të planit të punës për periudhën janar-qershor". Po ashtu, u miratua edhe raporti financiar për periudhën janar-qershor dhe raporti i shpenzimeve të derivateve janar-qershor.

Kënaqshmëria me drejtimin ekonomik kapi vlerën prej 17.79 %, duke u rritur për 6.97 pikë përqindje krahasuar me nëntorin 2022 kur ishte 10.82 %. Indeksi i Demokratizimit (ID) u ul për 0.04 pikë (1.48) krahasuar me nëntorin 2022 kur kjo vlerë ishte 1.52 pikë. Megjithatë, u shënua rritje për 0.17 në Indeksin e Besueshmërisë Ekonomike (IBE), i cili kapi vlerën prej 1.03, krahasuar me 0.86 në nëntor 2022. Si ID-ja ashtu edhe IBE-ja maten në një shkallë nga 0 pikë (minimumi) në 3 pikë (maksimumi), ku vlerat nën 1.5 konsiderohen negative, ndërsa ato mbi 1.5 tregojnë qëndrim pozitiv të shumicës së qytetarëve në lidhje me indeksin e demokratizimit dhe ekonomisë.

Një numër dukshëm më i lartë i të anketuarve ishin të gatshëm të protestonin për arsye politike në prill 2023 krahasuar me nëntorin 2022 (24.2 %). Ky numër përputhet me numrin e qytetarëve që ishin gati të protestonin për arsye politike në prill 2022. Të dhënat e zbërthyer sipas përkatësisë etnike treguan se një numër më i madh i serbëve të Kosovës (40.5 %) ishin të gatshëm të protestonin për arsye politike në krahasim me shqiptarët e Kosovës (28.5 %) dhe pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës (29.5 %). Gjetjet tregojnë rritje të lehtë për sa i përket ndjenjës së sigurisë tek të anketuarit me 82.85 % që ndihen të sigurt kur janë jashtë. Të dhënat e zbërthyer sipas gjinisë treguan se më shumë

meshkuj (83.9 %) sesa femra (81.7 %) deklaruan se ndihen të sigurt dhe deri-diku të sigurt kur janë jashtë. Papunësia (32.7 %), varfëria (20.1 %) dhe inflacioni (11.6 %) u renditën tre problemet e natyrës më urgjente në Kosovë. Të dhënat e Pulsit Publik #24 kanë shënuar rënie të numrit të të anketuarve që perceptojnë se punësimi në institucionet publike të Kosovës bëhet në baza meritore. Vetëm 22 % e të anketuarve besojnë se punësimi në institucionet publike bëhet në baza meritore në prill 2023, krahasuar me 27 % në nëntor 2022. Mesatarisht, 23.5 % e të anketuarve pohuan se e perceptojnë që korrupsioni në shkallë të gjerë është i pranishëm

në institucionet publike dhe ndërkombëtare në Kosovë, krahasuar me 21.1 % në nëntor 2022. Kur u pyetën për të drejtën e tyre për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm dhe të pastër, gjithsej 14.5 % e të anketuarve pohuan se nuk kanë njohuri për këtë temë, dhe ky numër ka pësuar rënie që nga nëntori 2021 kur u shënua në vlerën prej 27.5 %, prilli 2022 me vlerën 18.5 % dhe nëntorin 2022 me 19.6 %. Gjithsej 38.3 % thanë se kishin pak njohuri për këtë temë, ndjekur nga 32.3 % që kishin njohuri mesatare për këtë temë dhe 14.9 % që kishin shumë njohuri për këtë temë. Puls i Publik #24 bëri pyetje edhe për drejtësinë tranzicionale. Të dhënat treguan se 58.4 % e

shqiptarëve të Kosovës dhe 70 % e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës besonin plotësisht ose besonin se marrëveshja ndërmjet Kosovës dhe Serbisë do të ndikojë pozitivisht në jetën e tyre, ndërsa 24.8 % e serbëve të Kosovës e besonin të njëjtën gjë. Sipas Pulsit Publik të UNDP-së, 45.6 % e qytetarëve të Kosovës nuk janë aspak të kënaqur me drejtimin politik të vendit. Ndërkaq, derisa 31.2 kanë preferuar të mbesin neutral, vetëm 23.2 % janë shprehur të kënaqur në përgjigjet e tyre. Gjithashtu, situatë e njëjtë është edhe te drejtimi ekonomik që po merr vendi. Numri i të pakënaqurve nga 44.59 % sa ka qenë në nëntor 2021, në prill të vitit 2023 ka shkuar në 57.9 %.



## Totaj: Avancimi i bizneseve për zhvillim në fushën digjitale përkthehet në zhvillim ekonomik

PRIZREN, 25 KORRIK - "Avancimi i bizneseve për zhvillim në fushën digjitale është e tashmja dhe e ardhmja që përkthehet në zhvillim ekonomik", u shpreh kryetari i komunës së Prizrenit, Shaqir Totaj, gjatë takimit të tipit "Business Breakfast", me

përfaqësuesit e shoqatave prizrenase të bizneseve, përfaqësuesit e ITP-së e GIZ-it, si dhe të provajderit të trajnimeve "Cactus Education e Skills Factory", me ç'rast u paraqitën mundësitë për ngritjen e kapaciteteve digjitale të

bizneseve. "Si përkrahës i komunitetit të biznesit dhe fuqizimit ekonomik të komunës së Prizrenit, përmes sektorit privat, u zotova për përkrahje maksimale institucionale të kësaj çështjeje", ka thënë Totaj.



## Aksion i përgjithshëm për ndaljen e keqpërdorimit të ujit të pijshëm në Rahovec

RAHOVEC, 25 KORRIK - Smajl Latifi ka bërë me dije se në cilësinë e kryetarit të komunës së Rahovecit, bashkë me drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Përparim Krasniqi, ka kërkuar një takim të jashtëzakonshëm me KRU "Gjakova", të cilin e kanë mbajtur të martën.

Latifi ka thënë se gjatë këtij takimi kanë biseduar për problemet me ujë të pijshëm, me të cilin po përballen banorët e komunës së Rahovecit, sidomos ata që jetojnë në zonat sipërore. "Në fokus patëm edhe problemet e krijuara nga keqpërdorimet që po bëhen me ujin e pijshëm e si pasojë ka mungesë të ujit. U pajtuam që të fillojmë një aksion të menjëhershëm të kontrollimit në koordinim me inspektorët e komunës së Rahovecit dhe Njësitin e Kontrollit të KRU

'Gjakova', i cili do të bëhet edhe me mbështetje të policisë. Ju vëmë në dijeni që duke u mbështetur në Rregulloren për Shërbimet Publike të KK Rahovec, nr. 01/2018, neni 157, këto janë gjobat me të cilat do të jepen ndaj keqpërdoruesve të ujit të pijshëm: - Personat fizikë: 20 - 1 000 euro; Personat fizikë që ushtrojnë biznes individual: 50 - 3 000 euro; Personat juridikë: 150 - 10 000 euro", ka bërë me dije Latifi.

Ai ka thënë se ky aksion do të jetë shumë serioz derisa të arrihet një stabilitet me ujin e pijshëm. "Ftojme qytetarët tanë që të bashkëpunojnë me ne për stabilizimin dhe furnizimin e ujit të pijshëm, ashtu siç e meriton secili qytetar, sepse: Uji është jetë", është shprehur kryetari Latifi.



## Inspeksioni në aksion për largimin e shitësve ilegalë në sheshin e Mitrovicës



MITROVICË, 25 KORRIK - Inspektorët komunalë mbrëmë kanë ndërmarrë një aksion për largimin e shitësve të cilët operojnë pa leje nga organet kompetente në hapësirat publike, konkretisht në sheshin e qytetit të Mitrovicës. Gjatë këtij aksioni në sheshin e qytetit janë sekuestruar disa lodra si dhe janë larguar disa shitës ambulanti të cilët zhvillojnë veprimtarinë e tyre biznesore pa leje, si dhe shfrytëzonin hapësirën publike duke penguar kështu lëvizjen e lirë të qytetarëve. Lidhur me këtë, udhëheqësi i sektorit për Shërbime Publike

dhe Mbrojtje të Mjedisit nga Drejtoria e Inspektionit, Fatmir Kelmendi, ka theksuar se disa herë shitësit në fjalë janë paralajmëruar që të mos vazhdojnë shfrytëzimin e hapësirave publike pa u pajisur me leje adekuate duke penguar kështu edhe lëvizjen e lirë të qytetarëve.

Ai ka shtuar se inspektorët komunalë edhe në ditët në vijim do të zhvillojnë aksione të tilla, të cilat sigurojnë qarkullim dhe lëvizje të lirë të qytetarëve, sidomos në këto ditë kur kemi frekuentim edhe nga bashkatdhetarët në qytetin tonë.

## Numër i madh i qytetarëve protestojnë në Klinë kundër ndërtimit të fabrikës së çimentos në fshatin Dollc

KLINË, 25 KORRIK - Shoqata për Ruajtjen dhe Mbrojtjen e Ambientit në Klinë ka protestuar kundër ndërtimit të fabrikës së çimentos në fshatin Dollc të Klinës. Sipas organizatorëve, banorët e Klinës dhe fshatrave përreth që nga fillimi e kanë kundërshtuar ashpër idenë për ndërtim të kësaj fabrike për faktin se ky ndërtim do ta

shkatërronte ambientin, burimet e ujit, florën dhe faunën.

Veton Rraci, kryetar i këshillit organizativ të protestës, tha se ndonëse kryetari i komunës u ka premtuar se fabrika nuk do të ndërtohet, pas shpinës së tyre ka marrë vendim për dhënien e lejes.

Rraci pohon se komentet e banorëve në dëgjime publike

janë falsifikuar dhe, si të tilla, janë përdorur për t'u pajisur me dokumentacion. Ai bëri me dije se ka takuar dhe ka marrë mbështetjen e Gazmend Muhaxherit, kryetar i komunës së Pejës dhe Ekrem Kastratit, kryetar i komunës së Malishevës, si dhe është në pritje të takimit me kryetarin e komunës së Gjakovës, të Istogut dhe të Skenderajt.





## Operacion shumë i rrallë e i ndjeshëm në QKUK, i shpëtohet krahu pacientit

PRISHTINË, 25 KORRIK - Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës ka njoftuar për një operacion shumë të rrallë dhe të

ndjeshëm në Klinikën Emergjente të QKUK-së. Në njoftimin për medie thuhet se pacienti A. R., 1987, e kishte pothuajse komplet të

prerë krahun e djathtë, (amputim subtotal) gjatë një aksidenti me xham në shtëpi. Sipas ShSKUK-së, intervenimi kirurgjik është

kryer me sukses të plotë dhe pacienti pas gjashtë ditësh në Kirurgji Vaskulare, u lirua në shtëpi në gjendje shumë të mirë shëndetësore.



## Ndryshimet që diaspora do të donte t'i shihte në Kosovë

PRISHTINË, 25 KORRIK - "Shumë gjëra do të doja të ndryshohen në Kosovë, por do ta veçoja largimin e mbeturinave", thotë për Radion Evropa e Lirë, Shyqyri Demaku nga Prishtina, i cili tash e 33 vjet, bashkë me familjen, jeton në Suedi. "Pastrimi nuk është në nivel. Këta kontejnerë që i keni për mbeturina, të futen nën tokë disi. Kjo duhet të ndryshohet dhe kjo mund të bëhet lehtë me angazhimin më të madh të institucioneve", thotë Shyqyriu, i cili Kosovën e viziton deri në tri herë në vit.

Ai dhe dhjetëra kosovarë të tjerë nga diaspora vizituan të hënën ambientet e Kuvendit të Kosovës dhe u pritën nga disa deputetë. Aktiviteti tradicional, i njohur si "Bashkatdhetarët në Kuvend", zgjat dy ditë.

Hysni Makovci, i cili vizitoi Kuvendin bashkë me djalin e tij, thotë se "syrin ia vrasin ndërtime të shumta në Kosovë". "Më mirë është të investohet në



shëndetësi. Do të duhej të kishte sigurime shëndetësore ashtu siç i kemi në Gjermani", thotë Hysniu.

Ai migroi në Gjermani gjatë kohës së luftës në vitin 1999. Vendlindjen e tij, Prishtinën, e viziton deri në katër herë në vit.

Hysniu thotë se duhet punuar edhe për rritjen e pagave në Kosovë, ku mesatarja sillet rreth 520 euro në muaj. "Kam motrat këtu dhe nënën dhe më duhet t'i ndihmoj. Dërgoj para çdo muaj. Edhe për mua është vështirë t'i ndaj ato mjete që i dërgoj në Kosovë, por punojmë shumë dhe ia dalim", thotë ai.

Diaspora e Kosovës është e përqendruar kryesisht në Gjermani, Zvicër, Austri dhe vende të tjera të Evropës.

Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, numri i qytetarëve të Kosovës që jetojnë jashtë vendit, deri në fund të vitit

2018, ka qenë mbi 850 000.

Vizitat e tyre në Kosovë janë më të shumta gjatë verës.

Sipas të dhënave të Bankës Qendrore të Kosovës, shpenzimet e diasporës në Kosovë në vitin 2022 - qoftë në hotele, restorante apo biznese lokale - kanë kapur vlerën e rreth 1.9 miliard eurove.

Diaspora dërgon shuma të konsiderueshme parash edhe në formë të remitencave - vlera e të cilave, vitin e kaluar, ka arritur në 1.2 miliard euro.

Kuvendin e Kosovës e vizitoi të hënën edhe Albion Krasniqi nga komuna e Klinës, i cili jeton dhe studion në Itali. Ai synon që një ditë të kthehet në Kosovë. Thotë se do të dëshironte që "ligjet që miratohen në Kosovë, të zbatohen", si dhe t'u jepet më shumë hapësirë të rinjve. "Mendoj se çdo i ri që jeton atje, në Itali, ka shumë aftësi që mund

t'i zhvillojë këtu dhe mund të kontribuojë më shumë këtu sesa në Itali", thotë Albioni.

Fatmir Bytyçi ka disa javë që bashkë me familjen gjendet në Kosovë. Me prejardhje nga Prizreni, ai ka emigruar në Gjermani në vitin 1992. Për Fatmirin, arsimit është fusha ku duhet investuar më së shumti në Kosovë. "Subjektet politike nuk i njohin problemet e arsimit... Një problem që nuk e kupton, nuk mund as ta zgjidhësh. Mendoj se arsimit është shumë i dobët në Kosovë", thotë ai për Radion Evropa e Lirë.

Sipas Bankës Qendrore të Kosovës, diaspora zë vendin e parë edhe sa iu përket investimeve të huaja në vend, që bëhen kryesisht në patundshmëri. Ndërtuesit konfirmojnë se deri në 70 për qind e blerësve janë nga diaspora.

## Abdixhiku pret në takim Szunyogin, shpalos planin shtatëpikësh për veriun

PRISHTINË, 25 KORRIK - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku, ka pritur të martën në takim ambasadorin e BE-së në Kosovë, Tomas Szunyog, me të cilin ka diskutuar për çështjet aktuale politike në vend.

LDK-ja ka njoftuar se në takim u bisedua edhe për nevojën e

stabilitetit në vend, për thellimin e bashkëpunimit në mes të Kosovës dhe BE-së dhe se rruga e vetme e duhur për Kosovën është integrimi euroatlantik.

Kryetari Abdixhiku i ka shpalosur ambasadorit Szunyog planin shtatëpikësh të LDK-së i cili përmban zgjidhjen e krizës në veri dhe

përmirësimin e imazhit të Kosovës në arenën ndërkombëtare.

Abdixhiku e njoftoi ambasadorin edhe për ecurinë e takimeve me aktorë të jetës publike në vazhden e ndërtimit të Rrugës së Re si dhe qëndrimet e LDK-së karshi të gjitha proceseve që po kalon vendi.





# Mungesa e fuqisë punëtore në Kosovë, Rafuna: Po shqyrtohet opsioni për punëtorë nga tri vende të huaja

PRISHTINË, 25 KORRIK - Drejtori i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Lulzim Rafuna, në një intervistë për "Telegrafi"-n, ka folur për situatën ekonomike në vend, mungesën e fuqisë punëtore me të cilën po përballen bizneset si dhe për temën e investimeve kapitale gjatë këtij viti.

Rafuna thotë se vitet e fundit bizneset janë përballur me vështirësi të shumta si pasojë e pandemisë, luftës në Ukrainë dhe inflacionit. "Për fat të mirë gjendja ka filluar të përmirësohet. Çmimet kanë filluar të stabilizohen jo vetëm në Kosovë, por edhe në gjithë eurozonën", shprehet ai.

Megjithatë Rafuna thotë se sfida më e madhe për bizneset sot në Kosovë është mungesa e fuqisë punëtore në disa sektorë. "Ndërtimi dhe gastronomia janë dy sektorët më të prekur nga mungesa e punëtorëve pasi që edhe janë dy sektorët më të përhapur në vend. Këta sektorë nuk kërkojnë punëtorë të kualifikuar, por



janë të ndikuar nga trendi që ka kapluar të rinjtë për largim nga vendi", tha Rafuna. Drejtori i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK) thotë se një ndikim në ikjen e punëtorëve nga Kosova lidhet me hapjen e tregut të Bashkimit Evropian. "Është një element që shumë vende të BE-së si Gjermania, Italia, Austria por

edhe Zvicra i kanë thjeshtuar në minimumin e mundshëm procedurat për marrjen e një vize të punës". Sipas Rafunës, edhe sistemi i arsimit në vend është fajtor për ikjen e të rinjve pasi kërkesat e tregut të punës nuk përputhen me ato kuadro që prodhojnë universitetet tona. Një tjetër faktor në këtë

drejtim, sipas tij, është edhe mungesa e kuadrit ligjor që t'i mbrojnë bizneset në vend. "Një kontest administrativ merr shumë kohë. Për biznesin në pyetje është koha. Koha është e çmueshme. Biznesi nuk ka kohë të presë me vite të tëra për të zgjidhur një kontest". Por, Rafuna thotë se Oda Ekonomike të Kosovës

bashkë me bizneset janë duke i menduar alternativat për ta zgjidhur këtë çështje. "Njëri opsion është riorganizimi i brendshëm i bizneseve për ta zbutur krizën e punëtorëve pasi nuk mund të zëvendësohen. Për shembull, në gastronomi mund të përdoret opsioni i vetëshërbimit, derisa në industri mund të ndihmojë procesi i automatizimit. Pra punën që e kanë kryer 20 punëtorë, me ndihmën e pajisjeve tash e kryejnë dhjetë punëtorë. Alternativa e dytë mund të jetë sjellja e punëtorëve nga Bangladeshi, Nepali, por ka edhe prej Turqisë. Ka kompani të interesuara për të sjellë punëtorë nga jashtë. Ka tashmë punëtorë nga Turqia që punojnë në Kosovë për kompani kosovare", ka theksuar Rafuna. Megjithatë Rafuna thotë se bizneset nuk ndihen të sigurt me këta punëtorë pasi që ka dyshime se të njëjtët mund ta përdorin Kosovën si trampolinë për të kaluar në vendet evropiane.

## Bie numri i familjeve përfituese nga skema sociale

PRISHTINË, 25 KORRIK - Agjencia e Statistikave e Kosovës ka bërë me dije se në muajin qershor ka pasur ulje të përfituesve nga skemat sociale. Në muajin qershor 2023 nga skema e ndihmës sociale kanë përfituar 21 131 familje me gjithsej 83 363 anëtarë që, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak (qershor 2022) që ishin 25 444 familje me gjithsej 100 395 anëtarë, ka një rënie të numrit të familjeve përfituese nga kjo skemë për 4 313 ose 17 %. Në muajin qershor të vitit 2023, krahasuar me muajin qershor vitit 2022, kishte rënie të numrit të përfituesve nga: skema për familjet e dëshmorëve dhe invalidët e luftës (1,7 %); skema e pensioneve bazike të moshës (-1,9 %); skema e pensioneve



kontributpaguese të moshës (-2,5 %); skema për pensionet familjare (-8,7 %); skema për pensionet e Trepçës (-18,3 %).

Rënie më të madhe ka shënuar skema për pensionet invalidore me -20,3 %. Mirëpo sipas të dhënave të

ASK-së, te disa kategori ka pasur rritje të përfituesve nga skemat e pensioneve krahasuar me një vit më parë

Në muajin qershor 2023, krahasuar me muajin qershor 2022, kishte rritje të numrit të përfituesve nga skema për mbështetje materiale familjeve që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara (23,6 %). Rritje të përfituesve ka pasur edhe skema e pensioneve për Forcën e Sigurisë së Kosovës (11 %); skema e kompensimit për punëtorët e arsimit që punuan gjatë vitit shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99 (5,1 %); skema e pensioneve të Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK) (3,7 %); skema e kompensimeve për personat e verbër (2,2 %); skema e pensioneve për personat me aftësi të kufizuara (1,7 %); skema për pensionet e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë (0,3 %).

## Mbi 45 milionë euro borxhe ndaj KRU "Prishtina"

PRISHTINË, 25 KORRIK - Kompania Rajonale e Ujësjellësit (KRU) "Prishtina" ka njoftuar se aktualisht borxhi ndaj shërbimeve të ujit është mbi 45 milionë euro. Kështu është bërë me dije një njoftimin e KRU

"Prishtina". "Borxhi ndaj shërbimeve të ujit është mbi 45 milionë euro, 40 milionë nga sektori i amvisërisë, mbi 5 milionë nga sektori i bizneseve të vogla e të mëdha. Nuk ka ujë të pijshëm pa paguar faturat e

ujit, ngaqë kemi një kosto të lartë të trajtimit të ujit dhe shpërndarjes përmes tubacioneve primare, sekundare e terciare deri te konsumatorët", thuhet në njoftimin për medie.





# Si nuk mbarojnë luftërat: Ukraina, Rusia dhe mësimet e Luftës së Parë Botërore

Nga Margaret MACMILLAN  
"Foreign Affairs"

Më 24 shkurt 2022, romancieri i madh ukrainas Andrey Kurkov dhe gruaja e tij u zgjuan në shtëpinë e tyre në Kiev nga zhurma e raketave ruse. Në fillim, ai nuk po mundte ta besonte atë që po ndodhte. "Duhet të mësohesh psikologjikisht me idenë se lufta ka nisur", shkroi ai. Shumë vëzhgues të pushtimit e ndjenë dhe vazhdojnë ta ndiejnë atë ndjenjë mosbesimi.

Ata u hutuan nga sulmi i hapur dhe masiv i Rusisë, dhe u mahnitën nga rezistenca e fortë dhe e suksesshme të Ukrainës. E kush në ditët e para të luftës, dhe teksa përparonin kolonat ruse, do ta kishin parashikuar se të dyja palët do të vazhdonin të luftonin ende, edhe pas më shumë se një viti?

Me kaç shumë armë, burime të tjera dhe me shumë trupa për të përdorur, duke si një përfundim i paramenduar se Rusia do ta dërrmonte Ukrainën dhe do të pushtonte brenda pak ditësh qytetet e saj kryesore. Megjithatë, lufta ka hyrë në vitin e saj të dytë dhe po vazhdon në një mënyrë shumë ndryshe nga sa pritej.

Përvoja e një lufte të madhe të mëparshme në Evropë – që e njohim si Lufta e Parë Botërore – duhet të na kujtojë kostot e tmerrshme të një konflikti të armatosur të gjatë dhe të egër. Dhe ashtu si sot, edhe ajo luftë pritej të ishte e shkurtër dhe vendimtare. Megjithatë, sot bota dhe Ukraina përballen me disa pyetje shqetësuese.

Sa kohë do të vazhdojë Rusia me fushatën e saj, edhe pse vazhdojnë të pakësohen shpresat e saj për të festuar fitoren? Çfarë dëmi dhe tmerrri më i madh do t'i shkaktohet Ukrainës dhe popullit të saj? Dhe kur do të munden vendet më të prekura nga konflikti, nga fqinjët e Ukrainës deri tek ato që janë anëtarë të NATO-s, të mos shqetësohen se lufta do të përhapet jashtë kufijve të Ukrainës?

E kaluara ofron gjithashtu një paralajmërim edhe më të errët. Dhe këtë herë, për të ardhmen, kur të mbarojë lufta në Ukrainë. Ukraina dhe mbështetësit e saj mund të shpresojnë për një fitore dërrmuese dhe rrëzimin e regjimit të Putinit. Por nëse Rusia lihet të zhytet në kaos dhe trazira, e hidhëruar nga humbja dhe e izoluar, me shumë nga udhëheqësit dhe njerëzit e saj që fajësojnë të tjerët për dështimet e saj, siç bënë shumë gjermanë në

dekadat ndërmjet dy luftërave, atëherë fundi i një lufte vetëm sa mund të hedhë bazat për një tjetër. Në pranverën e vitit 1914, pakkush mendonte se ishte e mundur një luftë tokësore midis fuqive të mëdha evropiane. Shtetet evropiane, siç supozonin me vetëkënaqësi banorët e tyre, ishin shumë të avancuara, tepër të integruara ekonomikisht dhe tepër "të civilizuar" për t'iu drejtuar konflikteve të armatosura ndaj njëra-tjetrës.

Luftërat zhvilloheshin ende në periferi të Evropës, veçanërisht në Ballkan apo në territoret koloniale, ku evropianët luftuan kundër popujve më pak të fuqishëm. Gati e njëjta gjë ishte e vërtetë në javët e para të 2022-shit. Udhëheqësit, politikë-bërësit dhe publiku i tyre në Perëndim prireshin ta shihnin luftën si diçka që ndodhte vetëm gjetkë, qoftë në formën e kryengritjeve kundër qeverive jopopullore apo në konfliktet në dukje të pafundme në shtetet e dështuara.

Pra si në vitin 1914 dhe 2022, ata që supozuan se lufta nuk ishte e mundur, e kishin gabim. Në vitin 1914, pati tensione të rrezikshme dhe të pazgjidhura midis fuqive evropiane, një garë e re armatimi dhe kriza rajonale, të cilat çuan në bisedimet për luftën.

Ngjashëm, në muajt para pushtimit rus të Ukrainës, Moskua kishte bërë të qarta Perëndimit ankesat e saj, ndërsa presidenti rus Vladimir Putin kishte dhënë shumë shenja për qëllimet e tij. Në esenë e tij të gjatë botuar në vitin 2021, Putin tha se jo vetëm që Ukraina ishte vendlindja e vetë Rusisë, por popujt e saj kanë qenë gjithmonë rusë.

Presidenti rus e kundërshtoi humbjen e fuqisë globale nga Moskua pas Luftës së Ftohtë, dhe ishte i bindur se do ta mposhte shpejt Ukrainën. Edhe në vitin 1914, fuqitë e mëdha kishin vetëm plane luftarake sulmuese, të bazuara tek fitoret e shpejta. Nëse Putin do të kishte bërë llogaritjet e duhura në fillim, ai ndoshta nuk do ta kishte pushtuar Ukrainën.

Ose të paktën do të ishte përpjekur të tërhiqte forcat ruse sapo të bëhej e qartë se nuk do të arrinte pushtimin e shpejtë dhe pak të kushtueshëm që priste. Por emocionet – pakënaqësia, krenaria, frika – mund të ndikojnë tek vendimet e mëdha dhe të vogla, dhe siç e tregoi 1914-a, mund të ndikojnë gjithashtu edhe tek përvojat e atyre që marrin vendimet.

Ashtu si Cari Nikolla II 108 vite më parë, edhe Putin kujtoi një poshtërim. Si oficer i ri i KGB-së, ai kishte parë drejtpërdrejt tërheqjen



e Perandorisë Sovjetike nga Gjermania Lindore dhe më pas shpërbërjen e vetë Bashkimit Sovjetik. Pastaj ai pa zgjerimin drejt lindjes të NATO-s dhe BE-së.

Një nga mësimet e luftës së Rusisë në Ukrainë, është se strategët perëndimorë duhet t'i kushtojnë më shumë vëmendje mënyrës sesi liderët gjetkë i shohin vendet dhe historitë e tyre. Për shembull, pushtimi i Tajvanit do të mbartte të gjitha llojet e rreziqeve për Kinën. Por kinezët mund të jenë të përgatitur që t'i marrin parasysh ato.

Siç e tregoi Lufta e Parë Botërore, luftërat shkojnë rrallë siç janë planifikuar. Strategët ushtarakë ishin të vetëdijshëm për rëndësinë në rritje të luftës së llogoreve dhe artilerisë, por ishin të papërgatitur për atë që shpejt u bë vija statike e frontit. Një luftë që ishte menduar të përfundonte brenda disa muajsh, zgjati më shumë se 4 vjet dhe kushtoi shumë më tepër në jetë njerëzore dhe burime ekonomike nga sa e kishte imagjinuar dikush në fillim.

Edhe pse lufta në Ukrainë është vetëm në vitin e saj të dytë, edhe ajo është shndërruar në një luftë llogoreve me kosto shumë të larta njerëzore. Një realitet i tillë nuk përjashton mundësinë e operacioneve të reja të rëndësishme nga secila palë dhe ndryshime momentale të vijës së frontit.

Më shumë se një vit pas luftës, përparimet ka të ngjarë të vijnë me një kosto shumë më të lartë. Siç e mësuan gjeneralët në Luftën e Parë Botërore, toka për të cilën është luftuar është më e vështirë për të ndryshuar duar. Dhe të dyja palët i kanë shfrytëzuar muajt e dimrit për të përgatitur mbrojtjen e tyre.

Megjithëse shifra të tilla duhet të trajtohen me kujdes, agjencitë perëndimore të inteligjencës kanë vlerësuar se gjatë disa prej luftimeve më të ashpra, Rusia ka pësuar mesatarisht më shumë se 800 të vrarë dhe të plagosur në ditë, ndërsa zyrtarët ukrainas kanë pranuar maksimum 200- 500 viktima nga radhët e tyre.

Sa më gjatë të zgjasë një konflikt, aq më të rëndësishëm bëhen aleatët dhe burimet. Në të dyja luftërat

botërore, Gjermania dhe aleatët e saj patën disa suksese të hershme. Por ndërsa lufta vazhdonte, koalicioni kundërshtar fitoi luftën ekonomike si dhe atë në fushën e betejës.

Në secilin rast, Britania e Madhe mund të mbështetej tek perandoria e saj jashtë shtetit për pasuri dhe lëndë të para. Më vonë Shtetet e Bashkuara u bënë siç e tha presidenti Franklin Roosevelt në Luftën e Dytë Botërore "arsenali i demokracisë" dhe një ushtri e fortë partnere.

Dominimi i burimeve dhe i fuqisë punëtore ishte jetik në arritjen e fitores së aleatëve.

Në fillim, Rusia u duk se kishte një avantazh të rëndësishëm ndaj Ukrainës, përfshirë një ushtri shumë më të fuqishme dhe më shumë burime nga gjithçka që mund të numërohej. Por ndërsa lufta ka vazhduar, aleatët e Ukrainës janë treguar më të rëndësishëm se fuqia e Rusisë.

Historia ka treguar se luftërat fitohen ose humben sa nga qasja në burime apo konsumimi i burimeve të armikut, edhe nga aftësitë e komandantëve të secilës palë dhe nga trimëria e luftëtarëve të tyre.

Ka të ngjarë që Ukraina dhe Rusia, ndoshta nën presionin e Kinës dhe Shteteve të Bashkuara, mund të bien një ditë dakord të bisedojnë për përfundimin e luftës. Koha mund të jetë jetike. Në Luftën e Parë Botërore, pavarësisht përpjekjeve për paqe – për shembull nga Papa dhe nga presidenti amerikan Woodrow Wilson – të dyja palët vazhduan të kapeshin pas shpresës së fitores në fushën e betejës.

Gjermania kërkoi armëpushim vetëm në verën e vitit 1918, kur komanda e lartë gjermane e pranoi se po humbiste. Por është e vështirë të imagjinohet se si do të dukej një zgjidhje e tillë në Ukrainë. Sepse ndërsa po rriten humbjet nga të dyja palët, dhe teksa dalin në dritë më shumë raporte mbi mizoritë e Rusisë, urrejtja dhe hidhërimi i akumuluar do të paraqesin pengesa të mëdha për çdo lëshim nga të dyja palët.

Në mënyrë të pashmangshme, në një luftë të gjatë evoluojnë

objektivat e të dyja palëve. Në Luftën e Parë Botërore, Gjermania synoi të zgjerohej për të përfshirë Belgjikën dhe ndoshta shtetet baltike dhe Ukrainën. Franca synonte të rimerrte provincat e saj të humbura të Alsas-Lorenës, teksa u grind me Britaninë se kush do të merrte pjesët më të mëdha të Perandorisë Osmane të mundur.

Në luftën aktuale, Rusia duket se ka hequr dorë për momentin nga pushtimi i Kievit. Por duket se është e vendosur të pushtojë sa më shumë pjesë që mundet nga Ukraina, dhe ta reduktojë atë që ka mbetur në një shtet të varfër dhe pa dalje në det. Nga ana tjetër, qeveria ukrainase, e cila në fillim synonte thjesht t'i rezistonte sulmit rus dhe të mbronte territorin e saj, ka deklaruar synimin e saj për ta dëbuar Rusinë nga e gjithë Ukraina, përfshirë Krimenë, si dhe nga pjesët e Donetskut dhe Luhanskut të pushtuara nga Rusia që nga viti 2014. Për sa kohë që të dyja palët vazhdojnë të shpresojnë për diçka që mund ta quajnë fitore, ulja e tyre në tryezën e bisedimeve do të jetë e vështirë.

Humbësit nuk e pranojnë lehtësisht humbjen dhe fitimtarët e kanë të vështirë të jenë zemërgjerë. Traktati i Versajës nuk ishte kurrë aq ndëshkues sa pretendonte Gjermania, dhe shumë nga klauzolat e traktatit nuk u zbatuan kurrë. Por Evropa e viteve 1920 do të kishte qenë një vend më i lumtur nëse aleatët nuk do të ishin përpjekur të nxirrnin dëmshpërblime të larta nga Gjermania dhe ta kishin mirëpritur atë më shpejt në komunitetin e kombeve.

Por historia mund të ofrojë shembuj më inkurajues. Pas Luftës së Dytë Botërore, Plani Marshall i SHBA-së ndihmoi në rindërtimin e vendeve të Evropës Perëndimore në ekonomi në lulëzim dhe, po aq të rëndësishme, në demokraci të qëndrueshme.


Nën kërcënimin e Luftës së Ftohtë, Gjermania Perëndimore dhe Italia, u lejuan të bashkoheshin me NATO-n dhe u bënë anëtarë kryesorë të aleancës transatlantike. Pra edhe armiqtë e dikurshëm mund të shndërrohen në partnerë të ngushtë. Kjo ofron një farë shprese se Rusia e sotme mund të jetë një ditë një kujtim po aq i largët sa është sot Gjermania e vitit 1945.

**Marrë me shkurtime**

*Shënim: Margaret MacMillan, profesoreshë e Historisë Ndërkombëtare në Universitetin e Oksfordit dhe autore e librit "Si na ndryshoi konflikti dhe lufta që i dha fund Paqes: Rruga drejt 1914-ës".*



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



# Krasniqi para duelit me Mohamedin: Frikën s'e mendoj kurrë, do të shihni diçka jashtë normales

PRISHTINË, 25 KORRIK - Boksieri kosovar Robin Haxhi Krasniqi ka thënë se nuk ia ka aspak frikën kundërshtarit, francezit Nadjib Mohammedi, me të cilin do të ballafaqohet më 5 gusht në kategorinë gjysmë të rëndë në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë. Ai ka thënë se është duke u përgatitur maksimalisht për ta fituar këtë luftë duke shtuar se të pranishmit në stadium do të shohin diçka "jashtë normales". "Përgatitjet janë, si gjithmonë, maksimalisht. Unë përpiqem gjithmonë të thyej rekorde të përgatitjeve të kaluara kështu që besoj që më 5 gusht do ta kemi një prezantim diçka jashtë normales... Frikën nuk e mendojmë kurrë, vetëm për fitore mendojmë dhe bëjmë plane se çfarë të bëjmë pas fitores", ka thënë Krasniqi. Krasniqi me ekipin e tij është duke vizituar qendrat kryesore të Kosovës, duke prezantuar rrugëtimin dhe të arriturat e tij në boks dhe nga takimi me qytetarët ai thotë se po merr infuzionin më të fuqishëm për të qenë një fitues i madh. "Këto na japin motiv, por kanë edhe energjinë që na marrin. Ky është infuzioni që e marrim më të fuqishmin për të qenë fitues i madh", theksoi Krasniqi. Për luftën mes Krasniqi dhe Mohamedit shitja e biletave është duke vazhduar edhe më tutje. Çmimi i tyre është 20 euro.



## SHKURT

**Të premten tërheqja e shortit për edicionin e ri të garave**

Komisioni i Garave i ka njoftuar klubet e Superligës dhe Ligës së Parë se në bazë të Rregullores së Garave tërheqja e shortit për edicionin e ri të garave do të bëhet të premten (më 28 korrik). Tërheqja e shortit për Superligë do të bëhet nga ora 12:00. Shorti i Ligës së Parë për Grupin A do të tërhiqet nga ora 13:00, ndërsa për Grupin B në orën 13:30.

**Aliti transferohet tek Alanyaspor**

Mbrojtësi i Përfaqësueses së Kosovës, Fidan Aliti, ka ndryshuar ambient në këtë afat kalimtar. Ekipi turk Alanyaspor ka njoftuar se ka nënshkruar me mbrojtësin kosovar. "Jam në dijeni për synimet e klubit. Qëllimi im është të kontribuoj në klub për t'u arritur ato synime", ka thënë Aliti për faqen zyrtare të Alanyaspor. 29-vjeçari para se të vinte në Turqi ishte pjesë e ekipit të Cyrihut në Zvicër. Hollësitë e marrëveshjes nuk janë treguar.

**Tenistët nga Kosova mbyllin garat në EYOF Maribor 2023**

Tenistët e Kosovës kanë mbyllur garat në Festivalin Olimpik Evropian për të Rinj EYOF Maribor 2023. Në garat individuale Ervin Doli pësoi humbje 2:0 në sete (6:0, 6:0) nga izraeliti David Morag, ndërsa Meldina Mislimi u mund nga Talita Giardi e San Marinos 2:0 (6:1, 6:0). Të martën u zhvilluan edhe meçet në çifte, ku Kosova në të dyja konkurrencat u përballë me Gjermaninë dhe në të dyja pësoi humbje të njëjtë 2:0 në sete (6:1, 6:0).

**Ndryshon orari i ndeshjes Moldavi - Shqipëri**

Ka ndryshuar orari i ndeshjes Moldavi - Shqipëri, e vlefshme për kualifikueset e Kampionatit Evropian "Gjermani 2024", që ishte planifikuar të luhej në orën 20:45 të datës 17 nëntor. UEFA ka pranuar kërkesën e palës moldave, që kishte rënë ndërkohë dakord në parim edhe me Federatën Shqiptare të Futbollit për ta ndryshuar orarin e fillimit të kësaj ndeshjeje nga 20:45 në 18:00 (sipas orës lokale evropiane). Shorti e ka vendosur Shqipërinë në Grupin E në këto kualifikuese, ku veç Moldavisë, Polonia, Republika Çeke dhe Ishujt Faroe janë kundërshtarët e tjerë të kuqezinjve.

# Ballkani shkatërroi Larnen, afër kalimit në fazën e tretë në Ligën e Konferencës

PRISHTINË, 25 KORRIK - Kampioni në fuqi i Kosovës, FC Ballkani ka bërë një tjetër paraqitje të shkëlqyeshme në stadiumin "Fadil Vokrri" në garat evropiane. Skuadra portokallezi, të martën në mbrëmje, ka shënuar fitore bindëse në duel me skuadrën nga Irlanda e Veriut, FC Larne, me rezultat 3:0. Në këtë mënyrë djelmohat e drejtuar nga Ilir Daja kanë bërë një hap të madh drejt kualifikimit në fazën e tretë të Ligës së Konferencës. Ballkani e ka dominuar plotësisht ndeshjen që nga fillimi, duke mos i lënë shumë hapësira kundërshtarit. Suharekasit kaluan në epërsi në minutën e 26-të, kur Albion Rrahmani u tregua i saktë nga penalltia, pasi paraprakisht Nazmi Gripshi u ndalë në mënyrë të palejueshme në zonën e mysafirëve. Epërsinë në 2:0 e shtoi Almir Kryeziu, me një gol të shkëlqyeshëm në minutën e 33-të, pas asistimit të Nazmi Gripshit. E ky i fundit e vërtetoi se kjo mbërmje ishte për të, ngase në minutën e



67-të arriti të shënojë gol me gjuajtje të fortë pas asistimit të Albion Rrahmanit. Tani Ballkanit i mbetet ta administrojë

epërsinë e krijuar në ndeshjen e kthimit që do të zhvillohet pas një jave në Irlandën e Veriut.



## Berisha dhe Shala përforcojnë Drenicën

SKENDERAJ, 25 KORRIK - Skuadra e Drenicës ka realizuar dy transferimet e para për sezonin e ri futbollistik 2023/2024. Mbrojtësi i njohur Visar Berisha dhe Bashkim Shala kanë vendosur ta veshin fanellën kuqezi të skuadrës nga Skenderaj. "Visar Berisha vjen te klubi ynë nga KF Liria, ku

ishte pjesë në edicionin e kaluar. Qendërmbrojtësi ka arritur marrëveshje me klubin deri në përfundim të edicionit 2023/24. Berisha ka qenë pjesë e KF Drenica edhe në vitet e kaluara", thuhet në njoftimin e klubit kuqezi. Drenica sezonin e ri do të bëjë gara në Ligën e Parë. "Mesfushori vushtrias,

Bashkim Shala, do të jetë pjesë e Drenicës në edicionin e ri. Shala vjen nga FC Vushtrria dhe ka përvojë të madhe në futbollin e Kosovës. Ai është bashkuar menjëherë në stërvitje me ekipin dhe do të jetë nën urdhrat e trajnerit Keçi", ka njoftuar skuadra e Drenicës.



## Drejtori i Mercedesit: Red Bull i Verstappenit duket si një makinë e Formulës 1 mes atyre të Formulës 2

STUTTGART, 25 MAJ - Me 11 fitore në po kaq gara të zhvilluara deri më tani në këtë botëror (9 Max Verstappen e dy Sergio Perez) makina Red Bull i ka befasuar të gjithë me paraqitjen. Një makinë e pakapshme nga rivalët, që e mbyll garën me një dallim shumë të madh nga skuadrat e tjera. Një imazh ky i këtij botërori të Formulës 1, që askush nuk e kishte imagjinuar.

Toto Wolff, drejtori sportiv i Mercedesit, komenton kështu epërsinë që makina Red Bull ka me rivalët: "Do të donim të paraqiteshim më mirë në garë, por kjo nuk ka shumë rëndësi, pasi e para renditet një makinë që ka 34 sekonda nga vendi i dytë. Dhe, me shumë gjasë, në shumicën e garës nuk ka dhënë maksimumin e saj. Kjo tregon diferencën e madhe mes skuadrave". "Makina Red Bull e Max Verstappenit ishte si një



makinë e Formulës 1 që garon mes atyre të Formulës 2. Nëse Hamiltoni e Norris duelonin për podiumin dhe ishin si dy makina të F2, Verstappenit ishte i një kategorie më lart. Kjo tregon se na duhet të punojmë më shumë për të qenë kompetitivë sezonin tjetër", ka shtuar Wolff. "Mendoj se për vitin 2024 janë të

nevojshme shumë ndryshime. Drejtimi në të cilin është fokusuar puna jonë për të ardhmen është shumë interesante. Po shqyrtojmë me kujdes çdo koncept, për të mos pasur më surpriza të tilla. Çdo filozofi që kemi parë te makinat e tjera është e rëndësishme", ka pohuar Toto Wolff.

## Djokoviqi: Federeri dhe Nadali kishin pika të dobëta, ndërsa Alcaraz është i kompletuar

LONDËR, 25 KORRIK - Novak Djokoviq nuk e ka kaluar ende zhgënjimin e pësuar nga humbja e finales së grand slam të Wimbledonit, ku u mund 3-2 në finale nga spanjoli Carlos Alcaraz. Serbi ka vendosur të mos luajë në turneun Masters të Torontos, për t'u paraqitur në atë të Majemit dhe më pas në US Open. Duke folur për rivalitetin me Alcaraz, tenisti ballkanas shprehet: "E dija që në fushat me dhe niveli i tij ishte rritur ndjeshëm, por më befasoi me nivelin e tij edhe në fushat me bar. Të gjithë u befasuam. Nuk kishte arritur shumë fitore aty, por këtë vit fitoi si në Queen's ashtu dhe në Wimbledon". "Mendoj se fitorja në Queen's e ndihmoi shumë për t'u përgatitur për Wimbledonin. Pavarësisht kësaj, ai po luan një



tenis të jashtëzakonshëm në të gjitha sipërfaqet dhe e meriton të jetë numri 1 në botë", u shpreh Novak Djokoviq. Serbi ka bërë edhe një krahasim të 20-vjeçarit spanjoll me rivalët e tij të përherëshëm, Federer e Nadal. "Njerëzit e kanë thënë që ai është një miks i ne të treve. Mendoj se ka marrë më të mirën nga ne. Ka një rezistencë mendore të admirueshme. Ka një

mentalitet spanjoll, si ajo e Nadalit që kemi parë në gjithë këto vite", ka shtuar Djokoviq. "Federeri e Nadali kanë pika të dobëta në lojën e tyre, ndërsa Alcaraz i kompletuar. Ka një aftësi të jashtëzakonshme për t'u adaptuar dhe mendoj se do të ketë një karrierë të gjatë dhe të mbushur plot me suksese, në të gjitha sipërfaqet", ka deklaruar Djokoviq.

### SHKURT

#### Qendra Nacionale e Xhudos në Pejë do të zgjerohet edhe më shumë

Qendra Nacionale e Xhudos në Pejë do të zgjerohet për t'u shndërruar në qendër ndërkombëtare për kampe trajnimi. Kështu ka bërë me dije ministri i Ministrisë për Kulturë, Rini dhe Sport, Hajrulla Çeku, përmes një postimi në "Twitter". Ai ka bërë me dije se projekti për zgjerimin e saj tashmë është hartuar, kurse ndërtimi do të nisë sapo të përfundojë procesi i shpronësimit. "Qendra Nacionale e Xhudos në Pejë po zgjerohet për t'u shndërruar në qendër ndërkombëtare për kampe trajnimi", ka shkruar Çeku. Sipas Çekut, zhvillimi i turizmit sportiv sjell reputacion për shtetin dhe qarkullim për ekonominë.

#### PSG-ja interesohet për Maldinin

Fundi i marrëdhënies me Milanin ishte një surprizë që erdhi në fillim të qershorit. Por për Paolo Maldinin nuk mungojnë ofertat prestigjioze nga bota e futbollit. Ish-shefi i anës teknike të skuadrës kuqezi, që pas largimit nga Milani nuk ka dhënë asnjë deklaratë, në ditët e fundit ka marrë një propozim për të qenë pjesë e stafit drejtues të Paris Saint-Germainit. Maldini që aktualisht ndodhet me pushime, nuk ka marrë ende një vendim në lidhje me të ardhmen e tij. Përveç PSG-së, edhe kombëtarja italiane e futbollit mendon për Maldinin. Federata italiane i ka bërë një propozim ish-mbrojtësit legjendar, po ende nuk është saktësuar roli i tij në ambientin e kombëtares.

#### Kimmich: Nuk largohem nga Bayerni

Mesfushori i Kombëtares së Gjermanisë, Joshua Kimmich, është në qendër të thashethemeve të merkatos për një largim të mundshëm nga klubi i Bayern Munchen. Në lidhje me këto zëra, ka qenë vetë mesfushori i cili ka mohuar se do të largohet nga kampionët e Bundesligës. "Unë jam shumë qartë dhe shumë i sigurt që do të qëndroj këtu te Bayern Munichu. Unë do të luaj këtu sezonin e ardhshëm. Nuk kam plane të tjera", është shprehur Kimmich.

#### Gundogan: Jam te Barcelona për ta fituar tripletën

Ilkay Gundogan iu ka bashkuar Barcelonës për të fituar gjithçka. Ai ishte një nga lojtarët kryesor në fitimin e tripletës historike për Manchester Cityn. Gundogan e sheh veten duke fituar Ligën e Kampionëve edhe këtë vit me skuadrën, me të cilën ëndërronte të luante një ditë. "Nuk mund t'i thuash jo Barçës. Që i vogël kam ëndërruar të luaj për këtë ekip. Gjithashtu, kam parë potencialin e skuadrës... dhe çfarë mund të bëj më mirë skuadra", ka thënë Gundogan për "Mundo Deportivo". "Jam këtu për ta fituar Ligën, Kupën dhe Ligën e Kampionëve. Jam shumë i motivuar dhe kam ardhur këtu për t'i dëshmuar vetes se ia vlen edhe pse 32 vjeç. Sfidat nuk do të jenë të lehtë, por më pëlqejnë sfidat e vështira. Kam ardhur për të shijuar dhe, mbi të gjitha, për të fituar. Unë mendoj se ne mund ta fitojmë Ligën e Kampionëve. Ka cilësi, por ju nuk keni nevojë vetëm për cilësi, keni nevojë për mentalitet, qëndrueshmëri dhe ndonjëherë edhe pak fat", ka shtuar Gundogan.

## Ten Hagen mohon interesimin e Unitedit për Mbappen

Trajneri Erik ten Hag ka refuzuar të flasë për spekulimet që sugjerojnë se Manchester Unitedi mund t'i bashkohet interesimit për


Kylian Mbappen. Sulmuesi mund të largohet nga Paris Saint-Germain pasi e bëri të qartë se ai nuk do ta zgjasë kontratën që do të skadojë në

vitin 2024. Real Madridi ka qenë shumë i lidhur me francezin, ndërsa skuadra e Arabisë Saudite, Al-Hilal, thuhet se ka paraqitur një

rekord botëror prej 300 milionë eurosh. I pyetur nëse Unitedi mund të tundohej të hyjë në garë për Mbappen, Ten Hag është përgjigjur: "Ne

kurrë nuk flasim për lojtarë që janë nën kontratë me klube të tjera". Interesim për francezin ka edhe nga Arabia Saudite.





# Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



[www.facebook.com/gjejpuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)

## RESTAURANT

# SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË



### Thirrja për ofertim

Green Bio shpk është përfytyrë i grantit nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural-Agjenca për Zhvillimin e Bujqësisë në kuadër të thirrje për aplikim për Projektet e Zhvillimit Rural 2022, andaj është duke kërkuar ofertues të kualifikuar që të ofertojnë për mallra, punë, pajisje si dhe shërbime si në vijim:

#### 1. Ngritjen e serrës në sipërfaqe prej 3000 m<sup>2</sup> (0.30 Ha) me këto specifika:

- Serrat nuk duhet të jenë të salduar;
- Materiali për ndërtimin e serrave duhet të jetë i zinkuar;
- Bazamenti duhet të jetë bërë nga shputa betoni me dim Ø 450mm dhe thellësi 500mm dhe me një gyp me diametër Ø 63 mm dhe trashësia e murit të gypit duhet të jetë së paku 2 mm;
- Shtyllat dhe harqet të jenë nga gypa të zinkuar me dimensione Ø 48 mm dhe trashësia e murit të gypit të jetë së paku 2mm;
- Mbushja e kapriatave (harku me përfurcues) duhet të jetë me gypa me diametër Ø 26 x 2mm;
- Pjesa e poshtme e kapriatave duhet të jetë me gypa me diametër Ø33 mm x2mm;
- Brinaket duhet të jenë me gypa me diametër Ø 26 mm x 2mm);
- Shtang imët e ndërtimit dhe X –sat si përfurcues duhet të jenë me gypa me diametër Ø 33 mmx2mm;
- Dyert duhet të jenë të vendosura në pjesën ballore me najlon ose poli karbon;
- Sistemi i ajrosjes në mënyrë mekanike, hapja e dritareve bëhet mekanikisht përmes gypave të zinkuar (të diametrit Ø 21.3) dhe të sforcuar me kapëse PVC ½;
- Folia plastike duhet të jetë 160 µ (me garanci 3-5 vjet).

#### 2. Sistemi i ujitjes për sipërfaqe 0.30 ha:

- Të jetë nga prodhuesi Grek me garancion 5 vjeçar.
- Ne përmbajtje te sistemit te ujitjes do të jenë gypat Ø 40, ventila Ø 16, mbyllëse Ø 16, filtër Ø 40, mbyllëse Ø 40, gypi Ø 16/25, gypa furnizues Ø 63 etj.

#### 3. Solaret 4 KW:

- Të përbehen nga panelet fotovoltaike, modeli oksolar 280w, inventori, modeli 7,6 kw, struktura metalike me material te zinkuar, siguresa fotovoltaike, modeli 10.3 x 38, gpv 20 A, mbajtës siguresë një polshe 10.3 x 38 1000 v dc, konektor fotovoltaike modeli mc4-4 mm2, kablo per lidhje te baterisë me rregullator, modeli novtk 6mm2, kablo solar modeli 4mm2.

- Makinë për shtrirjen e najlonit dhe gypit për ujitje ALPLER.
- Sistemi I vesimit.

Kompanitë e interesuara duhet të kontaktojnë direkt tek Green Bio shpk nëpërmjet e-mailit apo telefonit për të kërkuar një Ftesë për Kuotim tek adresa e cekur më poshtë deri më 02/08/2023 (5 ditë pune nga data e thirrjes)

- Emri i përfutuesit: **Green Bio shpk**
- Adresa:Fshati Vraniq, 23000 Suharekë
- Mob: +38349136856
- E-mail adresa: [green.bio2023@gmail.com](mailto:green.bio2023@gmail.com)

Ofertat/Propozimet duhen dorëzuar tek adresa e përfutuesit deri me 16/08/2023.(15 ditë pune pas publikimit dhe pranimit të Ftesave për Kuotim nga operatorët ekonomik).

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Enis Uka, shpall të pavlefshme diplomën dhe dëftesat e gjimnazit "FRANG BARDHI", drejtimi shoqëror.

- Emin Ibrahim, shpall të pavlefshme dëftesat 6-9 shkollës fillore "HARUN BEKA".

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesa e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m<sup>2</sup>. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

# Lume's Details

## Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi







## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

